

ANILA KRUTI  
**UDHËTIMET FANTASTIKE TË ARMIRIT**  
NOVELË

---

BOTIMET TOENA



*Dhuratë për*



Anila Kruti

UDHËTIMET  
*fantastike të* ARMIRIT

*novelë*

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2017

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Arlinda Rrushi

Ilustrimet dhe kopertina: Marcela Danglli

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

ISBN 978-9928-236-76-3

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: ++ 355 4 22 40 116

redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Në mëngjes qershori, dielli ishte fshehur pas reve. Armiri u nis me nënën në fushën e madhe afër minierës, të mbledhnin krom. Me vete kishin marrë edhe nga një kosh, të cilët do t'i përdornin për të mbledhur mineralet. Ditën e parë, e ëma i kishte hedhur vetëm disa gurë të vegjël në kosh, të dytën dhe të tretën pak më shumë, kurse ditët në vijim, koshi mezi ngrihej. Në ditën e shtatë, ai ishte shumë i rëndë. Armiri i vogël, e mbajti një copë herë mbi shpatulla, por po i dridheshin këmbët. Vështroi të ëmën. Ajo e kishte lënë pas. Pa barkun e saj dhe





koshin e rëndë që po e tërhiqte zvarrë. Mblodhi forcat dhe vazhdoi të ecte me vështirësi nga pesha që kishte mbi shpatulla. Pa sërish nga e ëma. Ajo kishte ndaluar dhe po e priste. Koshi i rrëshqiti nga duart dhe një gur i ra mbi këmbë. U shtri në tokë dhe mori frymë thellë. Njërën dorë e vendosi në tokë mbi gurët e kromit, ndërsa kokën e vendosi mbi kosh.

Ngriti sytë drejt qiellit. Sytë i ndeshën në kaltërsinë e tij të pafund. I lëvizi pak më tutje dhe vuri re ca re të bardha.

Puliti sytë disa herë, pastaj i mbylli. Ndjeu një zhurmë të lehtë mbi shpatull. I hapi lehtë qepallat e syve dhe vuri re një zanë të bukur të veshur me një fustan të bardhë me xixa. U çudit. Fërkoj disa herë sytë dhe pa që ajo ishte aty. Zana u rrotullua disa herë pranë fytyrës së tij. Dritat e shndritshme të fustanit dhe të krahëve të saj si të një fluturë e mahnitën edhe më shumë Armirin. Ajo buzëqeshi. I la në dorë një orë të vogël me disa forma të








çuditshme, rrahu krahët dhe humbi në hapësirë. Armiri vështroi me kureshtje orën që vezullonte në pëllëmbën e tij. E vuri në dorë dhe ajo lëshoi një dritë të kuqe.

Shtypi lehtë një prej butonave të saj dhe befas u ngrit drejt qiellit. U ngrit lart, me duart e hapura, sikur kërcente pupthi te krevati i prindërve të tij. Vështroi poshtë fushën, e cila u vesh menjëherë me një mantel të hollë ndriçues. Gurët ngjanin si perla me atë dritën e bardhë që i mbuloi. I rrahu dy-tri herë krahët dhe çau me shpejtësi të rrufeshme hapësirën. Përnjëherë u gjend mbi re dhe u shtri lehtas mbi njërën prej tyre. Këmbët i dilnin jashtë. Provoi një tjetër pak më të madhe; qëndroi një copë herë ashtu. Papritur ajo filloi të shkrihej. U rrokullis në disa re të tjera në ngjyrë rozë. Pastaj u shtri barkas. Pastaj nga e majta e mandej nga e djathta dhe, më në fund, gjeti rehati i shtrirë i tëri me kurriz në një re të bardhë të dendur, që i ngjante një elefanti. U rehatua





dhe vuri duart pas kokës. Ndenji një copë herë i përhumbar, ndërsa pa që pak më tutje ishte një pemë në formë dielli, në të cilën vareshin akulllore të bardha reje, të mbushura plot me qumësht. Hëngri sa u ngop dhe, ndërsa u bë gati të ikte, futi një akulllore në xhep për nënën, që kushedi sa ishte lodhur atë ditë.

“Sa do të gëzohet ajo!”, mendoi.

Teksa bëri disa hapa, u kujtua për vëllain, i cili do të vinte në jetë pas disa muajsh.

Rrëmbeu edhe një tjetër nga pema dhe e futi në xhep. Filloi të bënte kollotumba nëpër re, gjersa pa bishtin e një ylberi që dukej pak më tutje. U hodh edhe një herë dhe, bishti i orës, i kapi te të çarat e pantallonave. Pa pantallonat dhe vuri re që ishin të grisura te gjunjët. E hoqi me kujdes andej dhe kapi bishtin e ylberit. Ai e rrotulloi disa herë dhe më pas kaloi në anën tjetër të rrugës së qiellit. U gjend para një pragu të gurtë, në gjysmë errësirë. Vështroi disa herë andej-këndeje dhe ndoqi me sy ylberin






që po fashitej. Vërejtë duart që i shkëlqenin ende nga ngjyrat e patretura të ylberit. Psherëtiu dhe i fshiu duart te copat e çara të pantallonave. Befas, ato u arnuan dhe u mbushën me ngjyra. Armiri u mahnit. I pëlqyen aq shumë, sa u ngazëllye e filloi të vraponte nga gëzimi.

Po futej në brendësi të zonës së gurtë. Vende vende kishte errësirë e, pak më tutje, binte një dritë e lehtë e verdhë. Armiri qëndroi për një çast aty. Asgjë nuk pipëtinte. Hodhi një hap para dhe pa një si dritë me ngjyra. U çudit se nga vinte ajo dritë. Vështroi te gjunjët dhe buzëqeshi. Ngjyrat e ylberit te gjunjët e tij i bënë dritë tek ecte. Qeshi, por duke parë dritën e gjunjëve u pengua dhe ra barkas. U vra pak te barku dhe ndjeu se diçka po lëvizte poshtë tij. U ngrit nxitimthi dhe ia futi vrapit kur dëgjoi pas tij fjalët e përsëritura nga një i panjohur:

- Unë jam roboti Juri, shoku yt shekullor. Unë jam roboti Juri, shoku yt shekullor.





Armiri ia kishte futur vrapit dhe nuk po dinte ku të fshihej. U fsheh pas një shkëmbi të vogël dhe ngjeshi gjunjët, që copëzat e arnuara të ylberit mos të bënë dritë. Mbajti frymën. Priti disa sekonda në heshtje, sa të largohej roboti. Psherëtiu një moment, kur ndjeu një gudulisje te këmba. U kthye i trembur dhe bërtiti:

- Aaaaaaa! U ngrit të ikte, më pas ndaloi dhe u kthye nga roboti, kur e dëgjoi sërish:

- Unë jam roboti Juri, shoku yt shekullor.

U kthye nga ai dhe e pa në sy. Ishte blu, siç kishte robotin e tij në shtëpi, të cilin ia kishte dhuruar një familje e pasur në lagjen e tij. Atij që kishte në shtëpi i mungonte një krah. E vështroi me kujdes: ishte njësoj si ai. U afrua edhe me afër. Po, po, njëlloj ishin, vetëm se ky kishte një cullufe të kuqe te balli dhe nuk i mungonin krahët. Qëndroi një copë herë ashtu. I shkoi sërish një e prerë në stomak, si të mos kishte ngrënë asgjë. Mendja i vajti tek akulloret që kishte në xhep dhe bëri të fuste dorën brenda,



por u kujtua që ato i kishte për nënën dhe vëllain që do të vinte në jetë. Rrudhi buzët.

- Do t'ia çoj nënës dhe pikë! - vendosi më në fund dhe tërhoqi duart larg xhepit. Bëri të ulej, por ia behu një e prerë tjetër edhe më e fortë në stomak. Nuk duroi dot më. Futi dorën në xhep dhe dora iu bë qull. Akulloret kishin shkrirë.

Psherëtiu. U ul rrëzë shkëmbit i trishtuar dhe mbajti barkun me dorë. Në atë çast pa robotin që ishte ulur pranë tij, i cili i zgjati një biskotë të madhe të mbushur plot me akullore prej reje. E vështroi një copë herë, më pas uli sytë përdhe, sikur nuk i interesonte. E pa sërish me bisht të syrit biskotën me akulloren qumësht të bardhë brenda saj dhe i shkoi goja lëng. Ia dha edhe një e prerë tjetër në bark edhe më e fortë. Zgjati dorën dhe i mori biskotën robotit. Po hanin bashkë, kur Armiri e përpiu sa hap e mbyll sytë, ngaqë kishte uri të madhe. Pas pak u ngritën dhe po shihnin yjet. Ishin aq afër, sa mund t'i kapje me dorë si vilet e rrushit.





Gjithë hapësira ishte e mbushur me dritë.

- Ja, Arusha e Madhe, - tregoi me gisht roboti Juri.  
Armiri shikonte i mahnitur.

- Ja, atje tej Arusha e Vogël, - tregoi ai ngutshëm  
me gishtin e dorës tjetër.

Armiri ktheu kokën dhe vështroi Arushën e Vogël. Kujtoi nënën dhe vëllain që do të vinte në jetë. U mallëngjye. I kishte marrë malli për ta. S'kaloi shumë dhe, përpara syve të tyre, kaloi një disk fluturues që u ndaloi te këmbët. Hipën dhe erdhën rrotull nëpër hapësirë. Vështtronin nga dritarja yjet që shkëputeshin dhe ndriçonin qiellin e, sa hap e mbyll sytë, fikeshin rrugës për në tokë.

- Ja, ai atje është planeti Mars, ose ndryshe Planeti i Kuq. Aty nuk ka jetë.

Roboti Juri, ndërkohë i fliste për galaktikën, planetët dhe çdo gjë fantastike që ata shikonin.

Armiri dhe Juri zunë të miqësoheshin shumë bashkë.



- Sa mirë që të takova, shoku im i ri! - tha Armiri dhe buzëqeshi.

- Unë jam roboti Juri, shoku yt she-ku-llor, - përsëriti pas tij roboti, duke rrokjezuar fjalën e fundit, - shoku yt i ri, - shtoi duke buzëqeshur dhe duke tundur kokën dhe cullufen e tij të kuqe.

Të dy qeshën dhe u shtrinë të flinin pas një dite të mbushur me aventurë, gëzim dhe lodhje.



# UDHËTIMI NË DETIN JON

Ashtu siç ishte shtrirë si në përhumbe, i erdhi sinjali i orës së kohës. Ajo lëshoi një sinjal të kuq dhe Armiri shtypi butonin e saj. Pas disa minutash u gjendën në detin Jon. Të zhytur me një shpejtësi marramendëse, Armiri dhe roboti i tij Juri u gjendën në thellësi të tij. Vështuruan përreth. Uji dukej i kristaltë në thellësi. Peshqit e vegjël me ngjyra të kuqe, blu, të verdha, si të ishte stampuar ylberi në lëkurat e tyre, që ishin grumbull, sapo ndienin një zhurmë të vogël përhapeshin e pushtonin gjithë hapësirën e ujit, si lule të vogla.



Algat lëviznin sipas një muzike të ëmbël, që, me siguri, e bënin sirenat.

- Uaaa! - u habit Armiri. - Sa bukur këtu poshtë në detin më të mrekullueshëm në botë! Panë këmbët dhe krahët. Ata mund të notonin. I pushtoi një gëzim i madh.

- Jemi në thellësi të detit Jon, - u dëgjua zëri i robotit Juri. Është rreth 4206 metra i thellë. Dallgët arrijnë deri në 4 metra lartësi.

Armiri e dëgjonte me vëmendje robotin dhe ndërkohë të dy vështronin bukuritë nënujore të detit Jon. Duke soditur pamjen mahnitëse që u shfaqej para syve, syri u zuri një arkë të vjetër druri në fund të detit. Armiri u ngazëllye.

- Gjetëm thesarin! Gjetëm thesarin! - thërriti me të madhe Armiri. Në ato momente i shkoi mendja te nëna. “Ajo nuk do të ketë më nevojë të mbledhë krom atje te fusha e madhe; as vëllai, kur t’i vijë mosha”, mendoi dhe i ndritën sytë nga gëzimi. U afruan pranë arkës. Armirit filluan t’i dridheshin

